

e ndryshme nen të cilat punojnë. Për këtë arsye janë krijuar disa rregulla të cilat kërkohet që të zbatohen nga korporatat në mënyrë që të zvogëlohet abuzimi me të drejtat e individit në shumë shtete.<sup>7</sup>

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut së bashku me një grup konventash të tjera kanë rezultuar të dobishme dhe potencialisht praktike për kompanitë që duan të sillen me përgjegjësi dhe na sjellin më afër seç kemi qenë ndonjëherë me një kuptim të përbashkët sesi bizneset duhet të mendojnë për të paktën disa nga përgjegjësitë e tyre themelore për të drejtat e njeriut.

Kemi arritur në kufijtë e asaj që mund të arrihet me qasjen aktuale të zbatimit të lirë të këtyre rregullave nga kompanitë botërore, dhe ka ardhur koha që qeveritë ta shikojnë drejtë problemin, të përballen me të duke pranuar përgjegjësinë e tyre për të mbikqyrur dhe për të rregulluar praktikën për të drejtat e njeriut nga ana e kompanive.

Vlen për t'u theksuar se mbrojtja e të drejtave të individit është në progresion nga viti në vit me anë të instrumentave të implikuara nga organizatat jo-qeveritare dhe qeveritare, por edhe si rrjedhojë e iniciativave vullnetare të korporatave për njohjen dhe zvogëlimin e abuzimit nga ana e tyre me të drejtat e individëve.

## Bibliografia

- Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut;  
 Papajorgji, E. "E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit", "ILAR". Tiranë 2012, fq. 66;  
 Gorezi, A. "Cikel Leksionesh ne te Drejten e Korporatave", "UET Press", Tiranë 2012  
<http://www.hrw.org>  
<http://www.ethicalcorp.com>  
<http://www.ihrb.org>  
 Mallezi, A. "E drejta shqiptare e shoqerive tregtare", "mediaprint", Tiranë 2011

## *Parimi Ne bis in idem në legjislacionin shqiptar dhe atë komunitar – vështrim krahasues*

*Ledia Meta, MSc*

### Abstrakt

*Të drejtat themelore të njeriut formojnë një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme të ligjit. Në formulimin dhe zbatimin e këtyre të drejtave, gjykatat marrin frymëzim nga traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare dhe nga udhëzimet e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbi të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar. **Ne bis in idem**, ose jo dy herë për të njëjtën, është një ndër parimet e rëndësishme të ligjit dhe konsiderohet si një element themelor i drejtësisë në procedurën penale. Ky parim ndalon shtetin nga ndjekja në mënyrë të përsëritur, dhe ndëshkimin e individëve për të njëjtën veprë. **Ne bis in idem** është themeluar gjithashtu si një e drejtë individuale në instrumentet ligjore në të drejtat ndërkombëtare të njeriut. **Ne bis in idem** ka qenë i zhvilluar në ligjin e BE-së nga një parim i brendshëm i shteteve, në një të drejtë themelore ndërkombëtare. Në këtë punim do të përqendrohemi në faktin se si trajtohet përgjithësisht parimi **ne bis in idem** në kuadër të së drejtës së brendshme dhe në të drejtën komunitare me qëllim për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e këtij parimi.*

**Fjalë kyç:** *Të drejta themelore, ne bis in idem, e drejta komunitare, res iudicata, procedurë penale*

<sup>7</sup> <http://www.ethicalcorp.com>

## Parimi *ne bis in idem*. Rëndësia e këtij parimi

A është e mundur që një person, i cili ka marrë një vendim penal të formës së prerë, të procedohet përsëri për të njëjtën gjë? Çështja shtrohet së pari në lidhje me legjislacionin e brendshëm. Shumica e legjislacioneve nuk e lejojnë një procedim të ri: gjykimi i formës së prerë pengon fillimin e procedimeve të reja sepse respektohet parimi *ne bis in idem*. E thënë shkurt, i njëjti shtet nuk mund të procedojë dy herë për të njëjtën gjë.

*Ne bis in idem* është një parim i përgjithshëm i ligjit (penal) në shumë sisteme ligjore kombëtare, ndonjëherë e parashikuar edhe si një e drejtë kushtetuese. Ajo gjithashtu është themeluar si një e drejtë e individit në të drejtën ndërkombëtare. A mundet një shtet të procedojë një person që është dënuar një herë nga një shtet tjetër për të njëjtën gjë. Ky procedim duhet të fillohet me iniciativë të vetë shtetit të dytë apo duhet që procedimi t'i përcillet atij nga shteti i parë? Përgjigja nuk është e lehtë. Sipas një forme konceptimi, është e mundur që të bëhet një procedim i dytë sepse e drejta për të proceduar është një atribut sovraniteti. Nuk është logjike të thuhet se shteti, në të cilin është kryer vepra dhe ku është më e lehtë të sigurohet prova, duhet të respektojë një vendim të marrë nga një shtet tjetër ku gjykata e ka shpallur personin të pafajshëm për arsye të provave të pamjaftueshme. Por sipas një koncepti tjetër, shumë më liberal, një procedim i dytë nuk duhet të bëhet për arsye barazie.

Lidhur me thelbin e parimit, tradicionalisht bëhet një dallim midis “*nemo debet bis vexari pro et eadem una causa*” (askush nuk duhet të përballet me më shumë se një ndjekje penale për të njëjtën veprë) dhe “*nemo debet bis puniri pro uno delicto*” (askush nuk duhet të dënohet dy herë për të njëjtën veprë). Ky është sigurisht një parim gjyqësor për mbrojtje të qytetarit kundër *ius puniendi*<sup>1</sup> të shtetit dhe si i tillë është pjesë e parimeve për shkak të ligjit dhe gjykimit të drejtë.<sup>2</sup>

Parimi *ne bis in idem* është një parim që kufizon mundësinë e një të pandehuri që të ndiqet penalisht në mënyrë të përsëritur në bazë të së njëjtës veprë, akti apo fakti.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> *Ius puniendi* - është një shprehje latine e cila përdoret për t'iu referuar fuqisë sanksionuese të shtetit. Nga zërrthimi i termit, në njërin anë “*ius*” do të thotë “e drejtë”, ndërsa termi “*puniendi*” do të thotë për të “ndëshkuar” dhe për këtë arsye mund të përkthehet fjalë për fjalë, si e drejta për të ndëshkuar. Termi është përdorur gjithmonë në referim të shtetit ndaj qytetarëve.

<sup>2</sup> John A.E. Vervaele. (2 December, 2005). The transnational *ne bis in idem* principle in the EU Mutual recognition and equivalent protection of human rights. Utrecht Law Rivew. Published by: igitur, fq.100. Marrë nga: <https://www.utrechtlawreview.org/articles/abstract/10.18352/ulr.10/>.

<sup>3</sup> B. Van Bockel. (2009), The *ne bis in idem* principle in EU law, Amsterdam: Ipskamp Drukkers, fq. 94 Marrë nga: <https://openaccess.leidenuniv.nl/bitstream/handle/1887/13844/000-diss-VanBockel-26-05-2009.pdf?sequence=1>.

Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron në ndalimin e dënimit dy (bis) a me shumë herë për të njëjtën (idem) normë penale, por tek mos dënimi apo gjykimi përsëri i subjektit aktiv të së njëjtës veprë penale/akti kriminal për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme e me një proces të rregullt.<sup>4</sup>

*Ne bis in idem* mund të aplikohet vetëm në ato raste kur si sjellja, ashtu edhe krimi, të analizuarra njëkohësisht, na bindin, në aspekt të ligjit se bëhet fjalë për të njëjtat fakte dhe të njëjtin ligj.

Që të ndodhemi përpara parimit *ne bis in idem* duhet domosdoshmërisht *ekzistenca e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë më parë, nga një gjykatë në mënyrë të ligjshme*. Kjo përbën edhe efektin tipik të *res iudicata* (gjësë së gjykuar), duke ruajtur kështu kuptimin e vet origjinal të prejardhur nga e drejta romake, të konsumimit të veprimit dhe pushtetit për të filluar ndjekjen gjyqësore mbi një fakt, kur i njëjti fakt ka qenë më parë subjekt i një procesi tjetër gjyqësor.<sup>5</sup>

Në fakt qëllimi i këtij parimi është që të krijojë një stabilitet juridik duke i krijuar bindjen individëve se pushteti gjyqësor nuk do të ushtrohet në një mënyrë arbitrare.

## Disa prej parashikimeve më të rëndësishme të parimit *ne bis in idem* në të drejtën komunitare dhe parashikimi i këtij parimi në rrafshin kombëtar

Edhe pse ekzistojnë dallime të konsiderueshme midis traditave ligjore të shteteve të ndryshme për sa i përket parimit *ne bis in idem* dhe arsyetimit themelor të tij, është përgjithësisht e pranuar se të gjitha kanë origjinë të përbashkët në ligjin romak, ku shprehja e plotë është “*bis de eadem re ne sit actio*”.

Parimi i *ne bis in idem* ka qenë i zhvendosur në nivel ndërkombëtar në kuadër të Bashkimit Evropian nga neni 54 i Konventës për Zbatimin e Marrëveshjes Shengen, i cili përcakton se “një person, gjykimi i të cilit ka përfunduar në një nga një Shtetet Kontraktuese, nuk mund të ndiqet penalisht nga një Shtet tjetër Kontraktuese, për të njëjtat vepra me kusht që, nëse dënimi është dhënë, ai ka qenë i detyrueshëm për t'u zbatuar, është në proces duke u zbatuar ose nuk mund të zbatohet sipas ligjeve të Shtetit Kontraktues që e ka dënuar këtë individ”. Ky instrument ligjor ndërkombëtar u integrua në kuadrin e ligjit të BE-së si pjesë e Konventës së Shengenit dhe e ka bërë parimin të detyrueshëm dhe të zbatueshme midis Shteteve.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Vendimi nr.5, datë 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>5</sup> Denar Biba, *Ne bis in idem*, Tetor 2005, Titanë: Jeta Juridike Nr.1, fq. 56.

<sup>6</sup> (2001). The Chengen *acquis* integrated into the European Union. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities. Marrë nga: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/SCH.ACQUIS-EN.pdf>

Ky parim gjen pasqyrim në shumë akte ndërkombëtare të rëndësishme por në kuadër të komunitetit ky parim parashikohet edhe nga neni 50 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, i cili parashikon se: “Askush nuk do të jetë përgjegjës për t’u gjykuar ose dënuar sërish për procedime penale, për një veprë penale për të cilën ai ose ajo ka qenë liruar ose dënuar brenda vendeve të Bashkimit ne perputhje me ligjin”<sup>7</sup>.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED), nga fillimi i viteve 1970, ka zhvilluar një gamë të plotë të parimeve të përgjithshme të ligjit të Komunitetit, ndër të cilat edhe parimin *ne bis in idem*.<sup>8</sup>

Gjykata Evropiane e Drejtësisë është shprehur se nocioni “e njëjta veprë” është një koncept autonom i ligjit të BE-së dhe aplikon praktikën e saj në përputhje me dispozitat e Komunitetit ose ligjit të BE-së, ku ajo nuk bën referencë të shprehur të ligjit të Shteteve Anëtare për qëllim të përcaktimit të kuptimit të saj dhe qëllimi i parimit duhet të jepet nëpërmjet një interpretimi autonom dhe uniform në të gjitha Shtetet Anëtare.

Parimi *ne bis in idem*, i cili përbën një ndër mekanizmat kryesorë mbrojtës të të drejtave të njeriut në sistemet ligjore të shumicës së shteteve, është i parashikuar edhe në të drejtën tonë kombëtare në nenin 34 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë cili parashikon se: “Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe as të gjykohe sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”.

Edhe neni 7 i Kodit të Procedurës Penale përmban një formulim pothuajse të njëjtë me nenin 34 të Kushtetutës. Ndalimi i gjykimet dy herë për të njëjtën veprë: “Askush nuk mund të gjykohe rishtas për të njëjtën veprë penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente”.

### Parimi *ne bis in idem* në rendin ligjor të BE-së

Bashkimi Evropian, që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Amsterdimit, ka qenë për realizimin e një zonë të përbashkët të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Me krijimin e Komunitetit, vendet anëtare i kanë dhënë jetë një rendi juridik të pavarur, i cili është i destinuar të integrohet me rendet e ndryshme juridike kombëtare<sup>9</sup>. Klasikja e bashkëpunimit ndërshtetëror në çështjet penale ka qenë zëvendësuar

<sup>7</sup> (2000). Official Journal of the European Communities. Charter of Fundamental Rights of the European Union. Marrë nga: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)

<sup>8</sup> Vervaele 2004, f. 795

<sup>9</sup> Erjona Canaj, Sokol Bana. (2010). E Drejta e Bashkimit Evropian i azhornuar me Traktatin e Lisbonës, Shtëpia botuese Arbëria 07, Tiranë, fq 42.

me përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor direkt midis aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, të cilët duhet të njohin vendimet gjyqësore të njëri-tjetrit bazuar në parimin e njohjes së ndërsjellë. Si rezultat, aspektet esenciale të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale, tani janë duke u zhvilluar në një zonë evropiane pa kufij të brendshëm, një zonë gjyqësore ndërkombëtare.

Në përgjithësi, parimi *ne bis in idem* zbatohet vetëm në fushën e së drejtës penale dhe të vendimeve përfundimtare në çështjet penale. Shumë nga çështjet e brendshme merren me përcaktimin e parimit *ne bis in idem*. Në fakt një *idem* faktik siguron një standard të lartë të mbrojtjes të së drejtës themelore për të mos u ndjekur penalisht dy herë për të njëjtën veprë penale, ndërsa interpretimi ligjor i konceptit “të njëjtën veprë penale” shpesh lejon një ndjekje të dytë mbi të njëjtën sjellje. Ai gjithashtu garanton respektimin e parimeve të dy shtyllave të njohura nga çdo sistem ligjor: siguria juridike dhe barazia. Gjykata kështu ka konfirmuar mbizotërimin e qasjes faktike për komponentin *idem* dhe ka forcuar garancinë e aplikimit uniform të parimit *ne bis in idem* në Bashkimin Evropian.

Interpretimi dhe zbatimi i parimit *ne bis in idem* në kuadrin ligjor të BE-së ngrë disa lloje problemesh. Sa i përket zbatimit të *ne bis in idem*, duhet të marrim parasyshë korniza të ndryshme: Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian dhe Zonën Shengen. Në secilën prej tyre aplikimi i parimit duhet të udhëhiqet nga instrumente të ndryshme ligjore. Për më tepër, të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së janë gjithashtu anëtarë të Këshillit të Evropës, dhe, si të tilla, shumë - dhe në disa raste shumica e tyre - janë palë në konventat e përfunduar brenda asaj organizate.<sup>10</sup>

Fakti se ekzistojnë një numër dispozitash që bëjnë përcaktime të ndryshme për parimin *ne bis in idem* nuk është problemi i vetëm për mbrojtjen nga rreziku i ndjekjes së dyfishtë brenda BE-së.

Vendimet gjyqësore të një shteti anëtar kanë efekt ligjor në fushën juridike të BE-së. Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në një vendim të saj, ka argumentuar se: “... i takon të gjitha autoriteteve të Shteteve anëtare, të pushtetit qëndror të Shtetit, autoriteteve të Shtetit federal ose autoriteteve të tjera territoriale, të garantojnë respektimin e normave të së drejtës komunitare në kuadrin e kompetencave të tyre...”<sup>11</sup>

Dispozita më e plotë në një konventë që themelon parimin *ne bis in idem* ndërkombëtar deri më sot është pa dyshim neni 54 i Konventës për Zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit.<sup>12</sup>

Parimi *ne bis in idem* ka qenë i përcaktuar në nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, i cili parashikon se “askush nuk do të jetë përgjegjës

<sup>10</sup> H-J. Bartsch. (2002). “Council of Europe-*ne bis in idem*: the European perspective”, fq. 1163. Marrë nga: <https://www.cairn.info/revue-internationale-de-droit-penal-2002-3-page-1163.htm>

<sup>11</sup> Vendimi datë 12 Qershor 1980 “Gjermania kundër Komisionit Evropian”, i Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane.

<sup>12</sup> Vervaele, 2005, fq. 107.

për të gjykuar ose dënuar sërish në procedurën penale për një veprë për të cilën ai ose ajo është liruar ose dënuar brenda Bashkimit në përputhje me ligjin. Memorandumi shpjegues ofruar nga hartuesit e Kartës së të drejtave themelore të Bashkimit Evropian sqaroi se “në përputhje me nenin 50, *ne bis in idem* vlen jo vetëm brenda juridiksionit të një shteti, por edhe brenda juridiksioneve të disa Shteteve Anëtare”<sup>13</sup>.

Në vitin 2005, Komisioni nisi një konsultim publik mbi parimin *ne bis in idem* dhe çështjen e juridiksionit pozitiv të konflikteve. Letra e Gjellbër për konfliktet e juridiksionit dhe parimin e *ne bis in idem-it* në procedurë penale, adresonte tre çështje kryesore:

- nevoja për të sqaruar elemente të caktuara dhe përkufizimet lidhur me parimin *ne bis in idem* të parashikuar në nenin 54 të KIMSH;
- pyetja nëse kërkesa që një dënimi duhet të ketë qënë “i detyrueshëm është në të vërtetë në procesin e zbatimit ose nuk mund të zbatohet me”, e përfshirë në nenin 54 të KIMSH, është ende e përshtatshme brenda BE-së;
- pyetja se a ekziston ende ndonjë nevojë për anashkalim e përmbajtjes së nenit 55 të KIMSH.

Pyetjet e referuara nga Gjykata e Lartë Rajonale e Stuttgartit lejoi Gjykatën të theksojë parimin e besimit të ndërsjellë, e cila mbështet në sistemin e urdhër-arresti evropian dhe theksoi se qëllimi i këtij Vendimi është për të krijuar një sistem të dorëzimit të bazuar në njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin efikas të urdhërit ndërmjet Shteteve Anëtare.

Struktura më e famshme e vendimit në këtë kontekst është mandat-arresti Evropian i cili zëvendëson procedurën e ekstradimit klasik. Njohja reciproke e secilit nga urdhër-arrestet e tjera, të çon jo vetëm në dorëzimin më shpejt të të dyshuarve brenda BE-së, por edhe për faktin se parimet ligjore të tilla si parimin *ne bis in idem* duhet të zbatohen edhe në nivel ndërshtetëror. Ky aplikim ndërkombëtar presupozon se fusha e zbatimit të parimit *ne bis in idem* në BE mbështetet mbi një standard të përbashkët.<sup>14</sup>

Në përputhje me këto parime Gjykata deklaroi se nocioni “e njëjta veprë” është një koncept autonom i ligjit të BE-së dhe aplikon praktikën e saj në përputhje me të cilat një dispozitë e Komunitetit ose ligjit të BE-së, ku ajo nuk bën referencë të shprehur të ligjit të Shteteve Anëtare për qëllim të përcaktimit të kuptimit të saj, duhet të jepet një interpretim autonom dhe uniforme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Gjykata e Drejtësisë ka dhënë udhëzime themelore dhe të qëndrueshme për interpretimin e parimit *ne bis in idem*.

<sup>13</sup> (11 October 2000). Draft charter of fundamental rights of the European Union, Marrë nga: [www.europarl.europa.eu/charter/pdf/04473\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/04473_en.pdf). Megjithatë, shënimet e shpjegimeve deklarojnë se ata nuk kanë asnjë vlerë ligjore dhe kanë për qëllim thjesht për të qartësuar.

<sup>14</sup> John A.E. Vervaele, fq.101.

Në çështjen Gozutok dhe Brugge të vitit 2003, Gjykata u shpreh se parimi *ne bis in idem* është sanksionuar në nenin 54 të KIMSH dhe kjo nënkupton që shtetet anëtare kanë besim të ndërsjellë në sistemet e tyre të drejtësisë penale, ku secili prej tyre e njeh ligjin penal në fuqi në Shtetet e tjera Anëtare edhe kur rezultati i dalë prej tyre mund të jetë i ndryshëm nga aplikimi i ligjit të tyre kombëtar.<sup>15</sup>

Për më tepër, duke sqaruar arsyen e parimit, Gjykata nënvizoi se “integrimi në Konventën Shengen (që përfshin Nenin 54 i KIMSH) në kuadrin e Bashkimit Evropian synon zgjerimin e integritimit evropian dhe, në veçanti, mundësimin e Bashkimit për të bërë më të shpejtë fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë të cilat janë objektivat e saj për ruajtjen dhe zhvillimin”.<sup>16</sup> Në të vërtetë, qëllimi i nenit 54 është që të sigurojë se askush nuk është ndjekur penalisht për të njëjtat fakte në disa Shtete Anëtare në llogarinë e tij duke ushtruar të drejtën e tij për lirinë e lëvizjes.

Si pasojë e parimeve të sipërcituara, Gjykata vendosi në çështjen Gozutok dhe Brugge se nëse më tej prokuroria e pushoi çështjen në përputhje me ligjin kombëtar të Shtetit Anëtar ku vendimi është marrë, kjo do të aplikohen në të gjithë Bashkimin. Ajo që fillimisht ishte një një dispozitë e një marrëveshjeje ndërkombëtare u zhvilluar në një instrument të njohjes reciproke, për shkak të kontributit me vendosmëri për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në BE.<sup>17</sup>

Gjykata e ka konsoliduar këtë qasje në një tjetër çështje të mëvonshme duke e interpretuar parimin *ne bis in idem* të nenit 54 KIMSH në dritën e të drejtës së lëvizjes së lirë dhe në kontekstin e integritimit evropian. Në këtë aspekt, Gjykata u shpreh në rastet C-436/04 Van Esbroeck<sup>18</sup>, C 150/05 Van Straaten dhe C-288/05 Kretzinger<sup>19</sup> se “kriteri i vetëm relevant për qëllime të zbatimit të nenit 54 të KIMSH është identiteti i akteve materiale, të cilat kuptohen si ekzistenca e një sërë fakteve të cilat janë të lidhura në mënyrë të pazgjidshme me njëra-tjetrën dhe se ky kriter zbatohet pavarësisht nga klasifikimin ligjor i dhënë për ato akte ose interesa juridike të mbrojtura.<sup>20</sup> Ajo që ka rëndësi nuk është klasifikimi ligjor i një krimi ose formulim i tij, por identiteti i akteve materiale.

Futja në legjislacionin e Bashkimit të neneve 54-58 të Konventës Shengen<sup>21</sup>, “ka qënë një pikë e rëndësishme referimi për krijimin e një traktati shumëpalësh ndërkombëtar bazuar në parimin *ne bis in idem*”<sup>22</sup>.

<sup>15</sup> Çështja Gozutog dhe Brugge, C 187-01 dhe C 385-01, datë 11.02.2003, paragrafi 33.

<sup>16</sup> Po aty, paragrafi 37.

<sup>17</sup> Çështja Gozutog dhe Brugge, C 187-01 dhe C 385-01, datë 11.02.2003.

<sup>18</sup> Çështja Leopold Henry Van Esbroeck, C-436/04, paragrafi 36.

<sup>19</sup> Çështja Kretzinger, C-288/05, paragrafi 29.

<sup>20</sup> Po aty, paragrafi 37; shiko gjithashtu, Çështjen C150/05 Van Straaten v. the Netherlands and Italy, paragrafi 48.

<sup>21</sup> The Schengen acquis. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 2001. Marrë nga: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/SCH.ACQUIS-EN.pdf>

<sup>22</sup> Vervaele 2005, fq. 109.

Marrëveshja Shengen e vitit 1985 dhe Konventa e zbatuar e Marrëveshjes Shengen e vitit 1990 (së bashku: Marrëveshjet Shengen), edhe pse përfundoi jashtë kuadrit të Komunitetit, ishte hartuar duke patur parasysh integrimin evropian, dhe janë të lidhura në mënyrë funksionale me objektivin e lëvizjes së lirë. Qëllim i Marrëveshjes Shengen ishte vendosja e qarkullimit të lirë të personave duke hequr kontrollet kufitare, ndërkohë në të njëjtën kohë duke implementuar masa zbatuese kundërbalancuese, të cilat çojnë në një rritje të zbatimit të ligjeve penale ndërkufitare të grupit të shteteve anëtare në Shengen. Në mungesë të rregullave mbi konfliktet pozitive të ligjit në të drejtën ndërkombëtare penale, kjo rritje në aktivitetin e zbatimit të ligjit brenda zonës Shengen do të çojë në një rritje të rrezikut të subjekteve për t'u ndjekur penalisht dhe për t'u dënuar në mënyrë të përsëritur në disa prej shteteve Shengen.

Neni 54 i Marrëveshjes Shengen zbatohet për një gjykim i cili “ka qenë zgjidhur në një nga Palët Kontraktuese”. Ai përcakton se një person i cili është gjykuar, “nuk mund të ndiqet penalisht në një Palë tjetër Kontraktuese”. Në kundërshtim me nenin 14 (7) të KNDCP dhe neni 4/7 KEDNJ si dhe neni 50 i Kartës, neni 54 i KIMSH nuk zbatohet për ndjekjet penale të shumëfishta brenda të njëjtin shtet, por vetëm për një ndjekje penale të dytë në një shtet tjetër Shengen.

Neni 55 i Konventës zbatuese të Marrëveshjes Shengen i lejon shtetet të bëjnë një delaratë me anë të së cilës ata deklarojnë se nuk janë të detyruara të zbatojnë nenin 54 të po kësaj Konvente.

Një shtet mund të ketë arsye të veçanta që të procedojë një kriminel dhe kur ky i fundit ka qenë më përpara objekt procedimi nga një shtet tjetër. Për këtë arsye është parashikuar në Konventë thënia *ne bis in idem* nuk zbatohet në rastet kur shteti deklaron se nuk është i detyruar të zbatojë parimin. Kemi tre raste të tilla:

- 1) Pikës së pari, parimi *ne bis in idem* nuk zbatohet “kur veprat janë kryer në të gjithë ose në një pjesë të territorit të shtetit anëtar” (neni 55/1 i Konventës së Shengeit). Pra shteti ku është kryer vepra e konsideron shumë të rëndësishme që autori i veprës të gjykohej nga gjykata e tij. Kjo për arsye se do të jetë më e lehtë të sigurohen provat dhe padia civile do të jetë më e lehtë për t'u ushtruar nga i dëmtuari. Por si mund të përcaktohet që një veprë është kryer në territorin e një shteti? Meqenëse çdo legjislacion kishte kriteret e veta, Konventa e viti 1972 parashikoi që çështja do të vendoset sipas dispozitave të ligjit kombëtar të shtetit që parashikon të fillojë një procedim të dytë (“.....Shteti anëtar ku është kryer vepra ose që konsiderohet si i tillë sipas legjislacionit të këtij shteti”).
- 2) Së dyti, parimi nuk zbatohet edhe “kur veprat në shqyrtim gjyqësor nga një shtet tjetër përbëjnë një cënim të sigurisë së shtetit ose të interesave të tij themelore” (neni 55/1 b, i Konventës së Shengenit). Ky është thelbi i parimit të kompetencës reale, i quajtur ndryshe parimi i mbrojtjes kombëtare.

- 3) Së treti, dhe së fundi, parimi nuk zotohet “kur vepra është kryer nga një funksionar që varet prej tij” (prej shtetit anëtar) “i cili ka shkelur detyrimet e tij” (neni 55/1 c, i Konventës së Shengenit).

Në lidhje me rastin e tretë, Konventa e vitit 1972 (neni 35/2) synon veprën e kryer “kundër një personi, një institucioni ose një sendi publik” ose “nga një person që ka një karakter publik në këtë shtet” (shteti që synon fillimin e procedimit të dytë).

Pra këto janë tri përjashtimet. Por sipas nenit 55/1 të Konventës së Shengenit, këto përcaktime duhet të përcaktohen nga vendet anëtare jo me vonë se në momentin e miratimit të Konventës. Gjithashtu, sipas dispozitës së nenit 56, dënimet e reja që mund të jepen nuk mblidhen për ata vetëm bashkohen. Nuk duhen caktuar dënime në raport të zhdrejtë me veprën.<sup>23</sup>

Nenin 56 të Konventës zbatuese të Marrëveshjes Shengen të vitit 1990 parashikon se në rast të një procedimi të ri nga një shtet kundër një personi tashmë të gjykuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën veprë nga një shtet tjetër, e gjithë koha e kaluar në kufizim lirie në territorin e shtetit të dytë duhet të zbritet nga koha e dënimit që mund t'i caktohet. Po ky nen parashikon gjithashtu një gjë edhe më të rëndësishme: “do të mbahen parasysh gjithashtu, nëse e lejojnë legjislacionet kombëtare, të gjitha dënimet e tjera përveç atyre me kufizim lirie që janë vuajtur tashmë nga personi”.

Dispozitat e Konventës Shengen kanë shërbyer si një model për disa nga dispozitat të parimit *ne bis in idem* në legjislacionin e BE-së në drejtësi dhe punët e brendshme. Në këtë kuptim Traktatet e Shengenit kanë shërbyer si një laborator testimi.

Neni 50 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian<sup>24</sup> parashikon se: “Askush nuk do të jetë përgjegjës për t'u gjykuar ose dënuar sërish për procedime penale, për një veprë penale për të cilën ai ose ajo ka qenë liruar ose dënuar brenda vendeve të Bashkimit ne perputhje me ligjin.”<sup>25</sup>

Në bazë të formulimit të dispozitës të nenit 50 përcaktohet se ajo mund të aplikohet në rastet në të cilat subjekti është liruar apo dënuar përfundimisht brenda Bashkimit. Fraza “brenda Bashkimit” lë shumë vend për interpretim. A do

<sup>23</sup> Jean Prodel, Geert Cortens, Gert Vermeulen, E drejta penale evropiane, 2010, fq. 79-80.

<sup>24</sup> Karta u shpall më 7 Dhjetor të vitit 2000 në Nice. Karta, aktualisht nuk është ligjërish e detyrueshme, por riafirmon, me kujdesin e duhur kompetencat dhe detyrat e Komunitetit dhe Bashkimit dhe parimin e subsidiaritetit, të drejtat që rezultojnë, në veçanti, nga tradita kushtetuese dhe obligimet ndërkombëtare të përbashkëta për Shtetet Anëtare, Traktati i Bashkimit Evropian, Traktatet e Komunitetit, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kartat Sociale të miratuara nga Komuniteti dhe nga Këshilli i Evropës dhe Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

<sup>25</sup> (18 December 2000). Charter of Fundamental Rights of the European Union. Marrë nga: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)

të thotë kjo se vepra duhet të ketë ndodhur brenda Bashkimit, apo duhet “brenda Unionit” të kuptohet si: “nga një gjykatë e një Shteti Anëtar”? Në të njëjtën linjë nuk është e qartë nga dispozitat nëse “ligji” duhet të kuptohet si “ligji i njërit prej Shteteve Anëtare”, si “ligji i Komunitetit”, apo të dyja. Përdorimi i termave “ligji penal” dhe “vepër penale”, në pamje të parë duket se përjashtojnë mundësinë e zbatimit të dispozitës të ligjit të Komunitetit, si dhe të gjitha zonat e tjera të ligjit, përveç ligjit penal.

Neni 51 i Kartës adreson qëllimin e aplikimit të Kartës. Ajo thekson se “Dispozitat e kësaj Karte janë adresuar tek institucionet dhe Organet e Bashkimit”. Formulimi i nenit 50 të Kartës nuk është domosdoshmërisht vendimtar në përcaktimin e fushës së zbatimit të parimit *ne bis in idem* që përmbahet në atë dispozitë. Në qoftë se dispozitat e Kartës janë “Drejtuar” institucioneve të BE-së dhe organeve, siç thuhet nga neni 51 i Kartës, neni 50 i Kartës ka për qëllim të zbatohet në të gjitha fushat e ligjit të Bashkimit.

E vetmja alternativë duket se do të jetë konsiderimi i nenit 50 të Kartës si një dispozitë e cila vlen vetëm për sistemet e të drejtës penale të Shteteve anëtare, si dhe në ato fusha të ligjit të Komunitetit, ku Komuniteti ka kompetencat e ligjit penal, dhe ku e drejta penale kombëtare ekziston, duke implementuar ligjet e komunitetit. Është e panevojshme të thuhet se një interpretim i tillë do të kufizojë në mënyrë drastike sferën e zbatimit të dispozitës. Në të kundërtën, nga neni 51 del që sfera e zbatimit të Kartës është veçanërisht e gjerë.

### ***Ne bis in idem* dhe *res iudicata* në legjislacionin shqiptar**

Dhënia e dimensionit ndërkombëtar e parimit *ne bis in idem* kërkon që i njëjti dimension t'i jepet edhe parimit *res iudicata*, ose parimit *ne bis in idem* t'i jepet një themel i ri. Parimi i gjësë së gjykuar i shërben kryesisht besueshmërisë në sistemin e drejtësisë në një juridiksion të dhënë, duke ndaluar disa gjykata të cilat po veprojnë brenda juridiksionit të tyre, duke kundërshtuar interpretimet e njëra-tjetrës për të njëjtat fakte. Për këtë arsye parimi i *res iudicata*, nuk siguron një bazë të përshtatshme për një parim ndërkomëtar të parimit *ne bis in idem*.

Parimi *ne bis in idem*, është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, që rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Sipas jurisprudencës kushtetuese, kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre,

të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Gjykata ka çmuar *se res iudicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit.<sup>26</sup>

Pranimi i parimit *ne bis in idem* në gjykimin dhe vendimmarrjen për një çështje penale kërkon përmbushjen e dy kriterëve që janë, ai i vepërës penale “të njëjtë” me të mëparshmen dhe ai i kryerjes së saj “përsëri”.

Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëjloj nga ligji.

Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Nëse gjenden elementë të njëjtë parimi “ne bis in idem” ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm.

Sipas kuptimit të mësipërm, kur me vendim të formës së prerë është vendosur për një çështje, atëherë ajo nuk mund të gjykohet përsëri. Ky rregull është i vlefshëm edhe për të gjitha gjykatat e tjera brenda kufijve të të njëjtit juridiksion.

Parimi *ne bis in idem* që ndalon rigjykimin e ridënimin për të njëjtën vepër, nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me karakter të ndryshëm, penal dhe disiplinor. I njëjti veprim mund të konsiderohet si në shkelje të dy ligjeve (normave) edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë që ligji (norma) tjetër nuk e ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia apo dënimi në bazë të njërit ligj nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit.<sup>27</sup> Siç jemi shprehur dhe më sipër në punim, ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtën normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme.

Gjykata Kushtetuese, është shprehur disa herë mbi parimin e “gjësë së gjykuar”. Sipas saj, “në aspektin formal e procedural, *gjë e gjykuar nënkupton mosankueshmërinë e vendimit, përfshirë vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës*,<sup>28</sup> ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit”.<sup>29</sup> Ndërkohë, në një vendim tjetër, Gjykata Kushtetuese ka lënë të kuptojë se “gjë e gjykuar” mund të përkohë me “formën e prerë”, duke u shprehur se: Parimi i gjësë së gjykuar (*res iudicata*) pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjykata

<sup>26</sup> Vendimi nr.47, datë 7.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>27</sup> Vendimi nr.5, datë 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>28</sup> Vendim nr.24, datë 12.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>29</sup> Vendim nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizimit të së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike.<sup>30</sup> Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Gjykata ka çmuar se *parimi i gjësë së gjykuar* përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.<sup>31</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërjnë se, ndonëse shprehja “gjë e gjykuar” është gjerësisht e përdorur në doktrinë, dhe deri diku edhe në jurisprudencë. kjo shprehje nuk gjendet askund e shprehur shprehimisht në legjislacionin penal e procedural penal Shqiptar. Pyetja e parë që shtrohet, është nëse “gjë-ja e gjykuar” përkon me shprehjen “formë e prerë”, të gjendur në legjislacionin vendas. Për këtë, Gjykata do të bazohet në përkufizimin e Raportit Shpjegues të Konventës Europiane mbi “vendimin final” ku “Një vendim është final, nëse, sipas shprehjes tradicionale, ajo ka fituar fuqinë e res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto të tilla ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim”, për të përcaktuar dispozitat përkatëse në legjislacionin vendas që parashikojnë rastet e shterimit të mjeteve të zakonshme në dispozicion dhe kalimin e afatit pa ushtruar ankim.<sup>32</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se shprehja “gjë e gjykuar” (*res judicata*) përkon me shprehjen “formë e prerë” e përdorur nga legjislacioni Shqiptar, për vendimet që marrin këtë status në rastet kur:

- a. Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të K.Pr.Penale; ose
- b. Palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415(1) dhe 435(1) të K.Pr. Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë.

<sup>30</sup> Vendim nr.2, datë 16.01.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>31</sup> Vendimi nr.15 datë 19.04.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>32</sup> Vendimi Nr.2 datë, 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se rekursi në Gjykatën e Lartë bëhet kundër “vendimeve të gjykatës së apelit”. Megjithatë, rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të ushtrohet kundër vendimeve që kanë marrë formën e prerë në kuptimin e gjësë së gjykuar. Gjithashtu, vetë neni 435 i K.Pr.Penale shprehet se “rekursi paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë”. Ndërkohë, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të dënimit, neni 462 parashikon se “Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë”.<sup>33</sup> Nga interpretimi i këtyre dispozitave kuptohet qartë se shprehja “formë e prerë” e përdorur nuk përkon me konceptin e gjësë së gjykuar, por me ekzekutueshmërinë e vendimit. Në fakt, një vendim i pa ankimuar në gjykatën e apelit ka marrë formën e prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar”, ndërsa një vendim i gjykatës së apelit, kundër të cilit ushtrohet rekurs brenda afatit të 30 ditëve ka marrë formën e prerë në kuptimin e “ekzekutimit të tij”. Kjo “kontradiktë” në dukje e shprehjes “formë e prerë” lidhet, në kuptimin e Kolegjeve të Bashkuara, me vetë zgjedhjen e ligjvënësit, i cili ka parashikuar se një vendim dënimi mund të vihet në ekzekutim pa marrë ky i fundit domosdoshmërisht statusin e *res judicata*. Vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, por nuk përbën gjë të gjykuar. E thënë ndryshe, çdo vendim dënimi që është gjë e gjykuar është gjithnjë i ekzekutueshëm, por jo anasjelltas, pasi jo çdo vendim i ekzekutueshëm është gjë e gjykuar. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë arrijnë në përfundimin se neni 432 i K.Pr.Penale, titulli “Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë” duhet kuptuar si Rekurs kundër vendimeve që nuk kanë marrë statusin e gjësë së gjykuar, por janë menjëherë të ekzekutueshëm.<sup>34</sup>

## Përfundime

*Ne bis in idem* është një koncept i njohur, megjithëse latin, i cili i përkthyer literalisht në shqip do të thotë: “jo përsëri për të njëjtën”- terminologji e ruajtur dhe në përkufizimet moderne që i janë bërë këtij parimi nga instrumenta të ndryshëm ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Parimi *ne bis in idem* është një parim shumë i njohur nga e drejta ndërkombëtare penale dhe i rrënjosur bindshëm në të drejtën e brendshme të të gjitha shteteve me legjislacion modern. Aktualisht ai është edhe një prej të drejtave të njeriut, i mbrojtur nga instrumente kryesore juridike që rregullojnë marrëdhëniet në këtë fushë.

Zhvillimet e globalizimit dhe integritet evropian paraqesin sfidat të reja për sistemet e ligjit dhe për parimet ligjore që shtrihen në zemrat e këtyre sistemeve. Parimin *ne bis in idem* në rendin ligjor të KE / BE-ja na ofron një shembull të qartë

<sup>33</sup> Me përjashtim të vendimeve pafajësisë, të përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vendime këto që vihen në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së vendimit.

<sup>34</sup> Vendimi Nr.2 datë, 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

të kësaj. Aplikimi i parimit *ne bis in idem* ndërmjet shteteve kërkon që shtetet të njohin vendimet e huaja penale të cilat tashmë janë bërë *res judicata*.

Një problem është çështja e konflikteve të juridiksionit dhe shpërndarja e rasteve ndërmjet Shteteve Anëtare. Edhe pse ky është një instrument i domosdoshëm për rregullimin e drejtësisë ndërkombëtare, parimin *ne bis in idem* nuk rregullon juridiksionin e legjislacionit penal midis Shteteve Anëtare. Janë të nevojshëm mekanizmat plotësuese për koordinimin e ndarjes së çështjeve ndërmjet autoriteteve të Shteteve Anëtare.

Mos zbatimi ndërkombëtar i parimit *ne bis in idem* është konsideruar të jetë veçanërisht problematik në pikëpamje të një gatishmëri në rritje nga ana e shteteve për të marrë juridiksionin jashtë territorialitetit në rastet penale.

Krahas individit, *parimi ne bis in idem* në një masë mbron edhe shoqërinë si një e tërë, në disa mënyra. Është vënë re se ekziston një lidhje mes parimit *ne bis in idem* dhe parimit të ligjshmërisë. Logjika themelore është se kërkesa e një formulim të mëparshëm i ligjit penal duhet të ekzistojë mbi faktin se ku bazohet procedimi penal” do të jetë thjeshtë një iluzion në qoftë se një person mund të ngatërrohet vazhdimisht me aspekte të ndryshme të së njëjtës vepër penale”.

Ndjekjet e shumta do të rrisin rrezikun e një bindje të gabuar. Parimi *Ne bis in idem* ndonjëherë është konsideruar si një sanksion kundër Autoritetit për ndonjë neglizhencë gjatë gjykimit të parë. Sidoqoftë ky parimi krijon një nxitje për zbatimin e ligjit me efikasitet.

## Bibliografia

- Biba, D. (Tetor 2005). *Ne bis in idem*. Tiranë: Jeta Juridike Nr.1.
- Corstes, G., Pradel, J., Vermuelen, G. (Përkthyer 2010). *E drejta penale europiane*. Tiranë: “PAPIRUS”.
- Erjona Canaj, Sokol Bana, (2010), E Drejta e Bashkimit Europian i azhornuar me Traktatin e Lisbonës, Tiranë: Shtëpia botuese Arbëria 07.
- John A.E. Vervaele. (2 December, 2005). The transnational *ne bis in idem* principle in the EU Mutual recognition and equivalent protection of human rights. Utrecht Law Rivew. Published by: igitur. Marrë nga: <https://www.utrechtlawreview.org/articles/abstract/10.18352/ulr.10/>.
- H-J. Bartsch. (2002). “Council of Europe-*ne bis in idem*: the European perspective”, fq. 1163. Marrë nga: <https://www.cairn.info/revue-internationale-de-droit-penal-2002-3-page-1163.htm>.
- (11 October 2000). Draft charter of fundamental rights of the European Union, Marrë nga: [www.europarl.europa.eu/charter/pdf/04473\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/04473_en.pdf).
- (18 December 2000). Charter of Fundamental Rights of the European Union. Marrë nga: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf).
- C. Van den Wyngaert and G. Stessens. (1999). “The international *non bis in idem* principle: resolving some of the unanswered questions” *International and Comparative Law Quarterly*

Vol. 48. Marrë nga: <http://journals.cambridge.org/action/displayAbstract?fromPage=online&aid=1529172&fileId=S0020589300063685>

- B. van Bockel, Leiden, Druk: Ipskamp Drukkers, (2009). “The *ne bis in idem* principle in EU law, a conceptual and jurisprudential analysis”, Amsterdam, and ISBN 978-90-9024382-5, fq.17. Marrë nga: <https://openaccess.leidenuniv.nl/bitstream/handle/1887/13844/000-diss-VanBockel-26-05-2009.pdf?sequence=1>
- (2001). The Chengen acquis integrated into the European Union. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities. Marrë nga: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/SCH.ACQUIS-EN.pdf>
- (2000). Official Journal of the European Communities. Charter of Fundamental Rights of the European Union. Marrë nga: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf).
- Vendimi datë 12 Qershor 1980 “Gjermania kundër Komisionit Evropian”, i Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane.
- Çështja Gozutog dhe Brugge, C 187-01 dhe C 385-01, datë 11.02.2003.
- Çështja Leopold Henry Van Esbroeck, C-436/04.
- Çështja Kretzinger, C-288/05.
- Vendimi Nr.2 datë, 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.3 datë 08.07.2013 I Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendim nr.2, datë 16.01.2013 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.47, datë 7.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.15 datë 19.04.2013 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendim nr.24, datë 12.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendim nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr.5, datë 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese.